



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
Ministri

Nr. ... Prot.

Tiranë, më 07.06.2011

URDHËR

260, datë 07.06.2011

PËR

AKREDITIMIN INSTITUCIONAL DHE TË DISA PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË SHKOLLËS SË LARTË UNIVERSITARE JOPUBLIKE "UNIVERSITETI "EPOKA"

Në mbështetje të Nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; dhe të nenit 62 të Ligjit Nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe vendimit nr.281, datë 12.3.2008 të Këshillit të Ministrave "Për licencimin e institucionit privat të arsimit të lartë "Shkolla e lartë "Epoka":

URDHËROJ:

1. Akreditimin institucional të Fakultetit të Arkitekturës dhe Inxhinierisë, Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Administrative të Shkollës së Lartë Universitare Jopublike "Universiteti "EPOKA" në përputhje me vendimin nr. 176, datë 30.05.2011 të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë, bashkëlidhur këtij urdhri.
2. Akreditimin e programeve të studimit të ciklit të parë me kohëzgjatje normale 4 vite akademike në përfundim të të cilëve lëshohet diplomë "Bachelor" në: "Arkitekturë", "Inxhinieri Ndërtimi", "Inxhinieri kompjuterike", "Ekonomik", "Financë/Bankë", "Administrim Biznesi", "Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare" në përputhje me vendimin nr. 176, datë 30.05.2011 të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë, bashkëlidhur këtij urdhri.

3. Shkolla e Lartë Universitare Jopublike "Universiteti "Epoka", të plotësojë rekomandimet e parashikuara në vendimin e Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë nr. 176, datë 30.05.2011.
4. Shkolla e Lartë Universitare Jopublike "Universiteti "Epoka", do t'i nënshtrohet vlerësimit dhe akreditimit periodik institucional dhe të programeve të studimit të përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri, çdo 6 vjet, sipas pikës 4, neni 62 i ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për Arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar.
5. Urdhri bëhet publik në faqen zyrtare të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.
6. Ngarkohet për zbatimin e këtij Urdhri Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë, Këshilli i Akreditimit të Arsimit të Lartë, Drejtoria e Zhvillimit të Arsimit Jopublik, Shkolla e Lartë Universitare Jopublike "Universiteti "Epoka".

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

